

MBIKQYRJE E SHOQËRISË CIVILE TË SEKTORIT TË SIGURISË DHE GJINISË

PËRMBAJTJA

Pse është gjinia e rëndësishme për mbikqyrjen e shoqërisë civile

Si mundet gjinia të integrohet në mbikqyrjen e shoqërisë civile

Sfidat dhe mundësitë e periudhës pas konfliktit

Pyetje pët të pyetur CSO

Më tepër informata

Ka njohuri të fuqishme se reformat e sektorit të sigurisë (SSR) duhet të përmbushin nevoja të ndryshme të sigurisë për meshkujt, femrat, djemtë dhe vajzat. Integrimi i çështjeve të gjinisë është gjithashtu çelësi për efektivitetin dhe përgjegjshmërinë të sektorit të sigurisë, dhe të pronësisë lokale dhe legjitimitetit të SSR proçeseve.

Ky Shënim Praktik jep një hyrje të shkurtër për përfitimet e integritit të çështjeve të gjinisë në mbikqyrjen e shoqërisë civile të sektorit të sigurisë, si dhe informatat praktike për të bërë këtë.

Ky shënim praktik bazohet në Vegël (Tool) më të gjatë, dhe që të dyjat janë pjesë e **Veglave (Toolkit) të Gjinisë dhe SSR**. E dizajnuar për të ofruar hyrje për çështjet e gjinisë për praktikantët dhe bërësit e politikës të RSS, Vegla përfshin 12 vegla me shënime praktike përkatëse – shiko më tepër për informata. A F

Pse është gjinia e rëndësishme për mbikqyrjen e shoqërisë civile?

Mbikqyrja e shoqërisë civile të sektorit të sigurisë, përfshirë këtu edhe SSR, përfshin pjesëmarrjen aktive të organizatave shoqërore civile (CSO) në definimin e politikave të sigurisë dhe përcaktimin e strukturave dhe praktikave të aktorëve të sektorit të sigurisë. Objektivi është për të siguruar përfshirjen e interesave dhe perspektivave të nivelit komunal dhe bazor në ofrimin e sigurisë së mbrendshme dhe të jashtme, dhe për të përmbjatur pronësinë dhe qëndrueshmërinë lokale. CSO merr pjesë në mbikqyrjen e sektorit të sigurisë në mënyra të shumta të ndryshme, përfshirë këtu edhe politikën e këshillimit dhe ekspertizën teknike, vëzhgimin, rritjen e ndërgjegjshmërisë, dhe hulumtimin dhe analizën.

Gjinia i referohet roleve dhe marrëdhënieve, tiparet e personalitetit, qëndrimet, sjelljet dhe vlerat të cilat shoqëria iu përshkruan meshkujve dhe femrave. “Gjinia” pra i referohet diferencave të mësuara mes meshkujve dhe femrave, derisa “seksi” i referohet diferencave biologjike mes meshkujve dhe femrave. Rolet e gjinisë ndryshojnë gjerësisht mbrenda dhe matanë kulturave, dhe mund të ndyshojnë me kalimin e kohës. Gjinia i referohet jo vetëm meshkujve dhe femrave por edhe marrëdhënieve mes tyre.

Përforcimi i pronësisë lokale

- Duke integruar çështjet e gjinisë dhe përfshimin e organizatave të gruas mund të gjeneron pronësi lokale të SSR proçeseve duke siguruar se edhe meshkujt edhe fermat janë të angazhuar dhe kanë mundësinë për të shprehur nevojat e tyre të dalluara, pikëpamjet dhe prioritetet. Kjo i bënë institucionet e sigurisë më tepër përfaqësuese, të përgjegjshme dhe legjitime në sytë e popullit.

Mbikqyrja gjithëpërfshirëse perms integritit të çështjeve të gjinisë

- Mbikqyrja e sektorit të sigurisë e cila vëzhgon se si politikat dhe institucionet e sigurisë dhe drejtësisë të adresuara me dhunë të lidhur me gjininë (GBV) mund të forcojnë kujdesin për sigurinë dhe drejtësinë.
- Mbikqyrja e sektorit të sigurisë e cila mban të përgjegjshme institucionet e sektorit të sigurisë për mbajtjen e vendit të punës për jodiskriminim dhe parandalimin e ngacmimit seksual dhe forma të tjera të GBV mund të zmadhojë prodhimin dhe efektivitetin operativ.

Fillimisht në vitin 2008 ky dokument u botua me titull «Toolkit on Gender and Security Sector Reform» nga ana e Zyrës për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut të OSBE-së (ODIHR), Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF) dhe Institutit Ndërkombëtar për Hulumtime dhe Trajnim për Avancimin e Femrave (UN-INSTRAW).

Në **Malezi**, CSO siç është Organizata AID e Gruas kanë vëzhguar zbatimin dhe efikasitetin e Aktit të Dhunës s vendit në Malezi, si dhe ofrimin e shërbimeve të saja për viktimat. Rezultatet ishin të përdorura për përkrahje në përmirsimin të përmbajtjen dhe zbatimin e kësaj legjislativë.

Në **Kamboxha**, organizatat e gruas dhe grupet e drejtave të njeriut siç është LICADHO bashkëpunojnë me agjencionet qeveritare të mbikqyrjes për të hulumtuar akuzat e abuzimit dhe të vëzhgojnë pajtueshmërinë me Ligjin e miratuar kohë më parë të KamShembullihës për Parandalimin e Dhunës Shtëpiake dhe Mbrojtjen e Viktimave. Ky ligj i jep policisë më tepër pushtet për të intervenuar në raste të dhunës shtëpiake dhe e forcon strehimin ligjor në dispozicion tek viktimat. Si shtesë e vëzhgimit, CSO ofron ndihmë ligjore dhe shtëpi të sigurta për viktimat.

Mbikqyrja efektive përmes përfshirjes së organizatave të gruas

- Organizatat e gruas janë shpesh burim i pasfrytëzuar për mbikqyrje të sektorit të sigurisë. Ato gjithashtu mund të forcojnë mbikqyrjen përmes:
 - Sigurimin e politikës së këshillimit në përmirsim të transparencës, përgjegjësisë dhe përgjegjshmërisë
 - Vëzhgimi i implementimit të marëveshjeve ndërkombëtare dhe regjionale, si dhe politikave kombëtare dhe institucionale.
 - Sigurimi i kapaciteteve të ndërtimit për organet e mbikqyrjes për çështjet e gjinisë.
 - Identifikimi i kërcënimeve të sigurisë dhe çështje që përballen me komunitete dhe individë
 - Lehtësimi i dialogut mes komuniteteve lokale dhe organeve të mbikqyrjes së sektorit të sigurisë.
 - Ngritja e ndërgjegjes publike se sit ë të mbahen të përgjegjshme institucionet e sektorit të sigurisë.

Pajtueshmëria me detyrimet nën ligjet dhe instrumentet ndërkombëtare

Marrja e iniciativës për të integruar çështje të gjinisë në mbikqyrjen e shoqërisë civile nuk është vetëm çështje e efektivitetit operativ; është e nevojshme të përputhet me ligjet ndërkombëtare dhe regjionale, instrumente dhe norma që kanë të bëjnë me sigurinë dhe gjininë Instrumentet kryesore përfshijnë:

- *Deklarata e Pekinjt dhe Platforma për Veprim (1995)*
- *Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara për Gruan, Paqe dhe Siguri (2000)*

Për më tepër informata, ju lutem shikoni Shtojcën e Veglave mbi Ligjet dhe Instrumentet Ndërkombëtare dhe Regjionale.

Si gjinia mund të integrohet në mbikqyrjen e shoqërisë civile?

Organet e vëzhgimit të sektorit të sigurisë

- Forcimi i pëesëmarjes së organizatave të gruas në organet formale të mbikqyrjes së sektorit të sigurisë, siç janë bordet e shqyrtimit civil, komisionet e ankesave publike, ekupe teknike të ekspertëve dhe grupe të pavarura vëzhguese (shiko Shembulli 1).
- Vendos çështje të gjinisë, siç është parandalimi i GBV ose punësimi i zmadhuar i femrave, në agjendën e organeve vëzhguese të sektorit të sigurisë.

Hulumtime dhe grumbullim i të dhënave

- Kujdesen për çështjet e gjinisë të janë të integruara në vlerësimet e mbrendshme dhe të jashtme ose shqyrtime të institucioneve dhe politikave të sektorit të sigurisë.
- Kujdesen për të gjitha të dhënat të jenë të ndara sipas seksit. Të dhënat e ndara sipas seksit i japin rrethanat e ndryshme të meshkujve dhe femrave, dhe është bazë e nevojshme për shërbimet e barabarta të sigurisë
- Kryen audit gjinor të instucionit ose politikës së sektorit të sigurisë
- Kryen analizë të gjinisë të proceseve të SSR dhe shpërndan rezultatet dhe rekomandimet nëpër mediat

dhe tek zyrtarët qeveritar dhe donatorët.

- Kryen analizë të buxhetit të gjinisë të shpenzimeve qeveritare në sigurinë dhe mbrojtjen ose të buxheteve institucionale të sektorit individual të sigurisë, me qëllim për të kuptohet më mire ndikimi i veçantë i ndarjes së buxhetit tek meshkujt dhe femrat. Përdoren këto rezultate si vegël për mbrojtje
- Kujdeset se femrat dhe organizatat e gruas janë të përfshira në audit, vlerësim, planifikim, implementim, vëzhgim dhe procese të evaluimit të ndërmara nga CSO.

Mbrojtja dhe ngritja e ndërgjegjes

Përdoret hulumtimi sensitiv gjinor dhe rezultatet e proceseve të vlerësimit dhe grumbullimit të të dhënave për të zhvilluar informatën publike dhe kampanjat e mbrojtjes për çështjet e sigurisë të lidhura me gjininë – siç është ngritja e ndërgjegjes se sit ë raportohet GBV në polici ose të lobohet për financimin e qeverisë programet e parandalimit të dhunës së armëve.

- Identifikohen mënyrat për të përcjellur këtë informatë tek popullatat e margjinalizuara (siç janë popullatat rurale, femrat analfabete, ose komunitetet etnike) të cilat mund të mos flasin gjuhën zyrtare.
- Synon mbrojtjen të nivele të ndryshme – lokale, krahinore dhe kombëtare – duke arritur tek bërësit kryesor të politikës të cilët mund të ndikojnë në programimin e sektorit të sigurisë.
- Të angazhohen mediat lokale duke shpërndarur informata nëpër gazeta të vogla, radio të komunitetit dhe stacione lokale televizive, si dhe media prizat shtetërore.
- Punon me mediat për të sensibilizuar gazetarët dhe të tjerët në dimenzionet e gjinisë të çështjeve të sigurisë dhe drejtësisë
- Përfshijnë meshkujt në kampanjë të mbrojtjes, posaçërisht ato që mirren me dhunën kundër femrave (shiko Shembulli 2).

Trajnim gjinor

Organizatave të gruas dhe CSO me ekspertizë gjinore mund të mbështesin zhvillimin dhe ofrimin e trajnimit gjinor për personelin e sektorit të sigurisë (shiko Shembulli 3), duke përfshirë:

- Kryerjen e trajnimit të vlerësimit të nevojave.
- Zhvillimin e materialeve për trajnim gjinor dhe trajnimin e furnizimit.

CSO-të pjesëmarrëse dhe efektive

CSO-të të cilat janë të përfshira në mbikqyrjen e sektorit të sigurisë gjithashtu kanë për detyrë për të rishikuar politikave dhe praktikave të mbrendshme ashtu që mund të të promovojnë barazi gjinore, dhe të sigurojnë kapacitetet mbrendor të çështjet gjinore:

- Të zhvillojnë politika dhe procedura të mundësive të barabarta të gjinive të cilat i adresohen çështjeve

të burimeve njerëzore, praktikat e rekrutimit, nevojat për kryerjen e punës dhe ngacmimi dhe diskriminimi seksual.

- Sigurojnë trajnim gjinor për të gjithë personelin – përfshirë edhe trajnimin për grumbullim të dhënave që janë gjinore sensitive dhe metodologjitë e hulumtimit
- Çështjet kryesore gjinore në punën e embikqyrjes së sektorit të sigurisë
- Zbaton audit të mbrendshëm gjinor për të vlerësuar kapacitetet e organizimit.

Gjithashtu në dispozicion në Mjeti 9...

- Fazat e Auditimit të gjinive SSR
- Pyetje për të pyetur kur planifikohet kampanja e mbrojtjes
- Këshilla për punimin me mediat
- Temat e trajnimit për ndërtimin e kapacitetit të mbikqyrjes së organizatave joqeveritare të grave
- Sit e forcohet legjitimiteti i rrjeteve të shoqërisë civile
- Shembuj nga Europa Lindore, Fixhi, Iraku, Rusia, Afrika e Jugut, Mbretëria e Bashkuar dhe Afrika Perëndimore

Sfidat dhe mundësitë post-konflikti

CSO-të mund të jenë bërë të fragmentuara ose të dobësuar gjatë konfliktit dhe si rezultat mund të mos kenë arritur legjitimitetin ose kapacitetin për të kryer efektivisht mbikqyrjen e sektorit të sigurisë. Në raste të tjera, bashkëpunimi mes CSO-të mund të zmadhohet në periudhën post-konflikti, pasi ushtria dhe policia reformohen, po si edhe pasiguria e vazhdueshme, janë brengat kyçe të shumë organizatave, duke t'iu ofruar atyre me mundësi për të punuar së bashku.

Sfidat për integrimin e çështjeve gjinore

- Kapaciteti i institucioneve shtetërore shpesh është i dobët, në shkallë që edhe nëse ka vullnet politik, mjetet për të siguruar shërbime të sigurisë dhe drejtësisë nuk janë të disponueshme në terme teknike, financiare ose të burimeve njerëzore.
- Ligjet, strukturat dhe mekanizmat për parandalimin dhe përgjigjen e GBV janë rrallë në vend, ose funksionojnë siç duhet.
- Personeli i sektorit të sigurisë mund të ketë kryer abuzime të të drejtave të njeriut, dhe mund të vazhdon të kryer abuzime gjatë kohës së paqes.

Shembulli 2 Përfshirja e burrave në luftën kundër dhunës ndaj gruas

Kampanja e Rripit të Bardhë (WRC) ishte nisur në Kanadë në vitin 1991 nga një grup meshkujsh që të angazhohen për të dhënë fund dhunës kundër femrave dhe të edukojnë meshkuj tjerë për këtë çështje. Përmes kampanjës së rritjes së ndërgjegjes, deklaratave publike dhe rrjetin e tyre rritës, anëtarët e WRC ofrojnë vizion alternativ të mashkullësisë jo dhunore dhe ofrojnë rol modela pozitivë për meshkujt dhe djemt në komunitetet rreth botës³.

Mundësitë për integrimin e çështjeve gjinore

- SSR proceset mund të hapin hapësirë politike për hyrjen e CSO në marjen e vendimeve të sigurisë dhe drejtësisë, që është një mundësi për të ngritur çështjet e gjinisë.
- Dëshmia tregon se rolet e gjinisë dhe marëdhëniet shpesh ndërrohen gjatë dhe pas konfliktit, që mund të hap hapësirë të rëndësishme për negocijimin e integritetit të çështjeve gjinore dhe zmadhimin e punësimit të grave
- Donatorët mund të kenë të gatshme të sigurojnë mbështetje për CSO me qëllim që të ndërtohet kapaciteti i tyre i mbikqyrjes së përgjegjshme gjinore.

Shembulli 3 Edukimi Seksual për forcat e armatosura të Mongolisë⁴

Organizata joqeveritare (NGO) Mongol Vizion punon çështje reproductive të shëndetit me ushtarët dhe oficerët të forcave të armatosura Mongoleze: **Çështja:** Rekrutët e rinj të forcave të armatosura të Mongolisë, posaçërisht ato nga fshatrat, kanë pak ose kurrfarë njohuri për HIV/AIDS dhe STI. . Rrjedhimisht, shkalla e STI ka qenë relativisht e lartë në mes të oficerëve dhe ushtarëve..

Qëllimi: Të fitohet mbështetja nga Ministria e Mbrojtjes dhe forcave të armatosura të Mongolisë për të rritur HIV/AIDS, STI dhe ndërgjegjen e shëndetit riproduktiv në mes të oficerëve dhe ushtarëve.

Palët kyçe të interesuara: Ministria e Mbrojtjes dhe shtabet e forcave të armatosura të Mongolisë.

Palët fillestare: Ushtarët/oficerët dhe partneret e tyre të seksit.

Qasjet dhe komunikimet: Letra ishin dërguar Ministrisë së Mbrojtjes dhe shtabet e forcave të armatosura, takime zyrtare dhe jozyrtare ishin mbajtur me zyrtar të lartë; ishte i zhvilluar projekt në bashkëpunim me zyrtar të lartë, punëtori ishte e mbajtur me zyrtar të lartë, dhe officer komandues dhe mjekë të njësive ushtarake prezantuan një raport për situatën aktuale të STI në mes të personelit të forcave të armatosura.

Indikatorët e suksesit dhe qëndrueshmërisë: Shëndeti seksual ishte i përfshirë në edukimin zyrtar arsimor të personelin ushtarak; ndërgjegje e ngritur e zyrtarëve të lartë; dhe përkrahje e zmadhuar nga Ministria e Mbrojtjes

- ✓ Si është shoqëria civile, përfshirë edhe femrat, të involvuara në proceset e mbikqyrjes?
- ✓ Si janë nevojat e posaçme të sigurisë të meshkujve dhe femrave të identifikuar dhe të zgjedhura?
- ✓ Sa meshkuj dhe femra punojnë në ushtri, polici, shërbime inteligjence, polici kufitare, doganë, imigrim dhe shërbime të tjera të zbatimit të ligjit, dhe me çfarë kapacitet (përqindja e femrave/meshkujve, sipas shkallës dhe kategorisë)?
- ✓ A janë masat në vend që të sigurojnë se femrat kanë mundësi të barabarta që të jenë pjesë e çdo institucioni të sigurimit?
- ✓ A është trajnimi gjinor i ofruar policisë, ushtrisë dhe shërbimeve të tjera të sigurisë?
- ✓ Çfarë masa janë në vend që të parandalojnë, hulumtojnë dhe dënojnë GBV nga personeli i sektorit të sigurisë?
- ✓ A ka fond adekuat për programet që kanë të bëjnë me gjininë?



Pyetje për të pyetur CSO-në

Një nga mënyrat më të mira për të identifikuar pikat e hyrjes për të integruar çështjet e gjinisë në proceset e SSR është që organizatat e shoqërisë civile të kryejnë një vlerësim. Më poshtë janë pyetje shembuj për gjininë që CSO mund t'ç'i përfshinë në SSR vlerësimin, vëzhgimin dhe evaluimin.

- Çfarë janë nevojat e posaçme të sigurisë dhe drejtësisë, perceptimet dhe prioritetet e meshkujve, femrave, djemve dhe vajzave?
- Vallë personeli i sektorit të sigurisë ka kapacitet për t'iu përgjigjur të gjitha këtyre nevojave? Nëse jo, pse jo?
- A janë femrat, meshkujt, djemt dhe vajzat në mënyrë të barabartë në gjendje që të kenë qasje tek shërbimet e sigurisë dhe drejtësisë?
- Дали безбедносната легислатива, политики и протоколите Vallë legjislativi i sigurisë, politikave dhe protokoleve është i përgjegjshëm ndaj gjinisë? A ka legjislativacion adekuat kundër GBV?

- A kanë qasje të plotë dhe të barabartë tek punësimim mbrenda në institucionet e sektorit të sigurisë?
- Çfarë është mjedisi i punës në mbrendi të institucioneve të sektorit të sigurisë? A ka probleme të malretimit seksual dhe bariera të tjera për avancimin e gruas?
- Vallë organet e mbikqyrjes të sektorit të sigurisë përfshijnë femra dhe konsultohen me organizatat e gruas?
- Vallë organet e mbikqyrjes të sektorit të sigurisë vëzhgojnë çështje të lidhura me GBV dhe mundësi të njëjta për meshkujt dhe femrat?

Më tepër informata

Burime

Amnesty International – *Vëzhgim dhe raport i abuzimeve të të drejtave të njeriut në Afrikë: Dorracak për aktivistët e komunitetit* 2002.

Amnesty International – *Politikat e kuptimit: Burim për aktivistët e të drejtave të njeriut*, 2006.

DCAF – *Mbikqyrja publike e sektorit të sigurisë: Një doracak për CSO për qeverisjen e sigurisë demokratike*, 2008 e ardhshme.

Fondi i parandalimit të dhunës shtëpiake – *Vegël për punë me meshkuj dhe djem për të parandaluar dhunën e lidhur me gjininë*, 2003.

Vigjilenca ndërkombëtare dhe bërja e paqes nga gruaja – *Duke përfshirë sigurinë, paqen e qëndrueshme: Vegël për mbrojtje dhe veprim*, 2004.

OECD DAC – *OECD DAC Dorracak për Reformat e Sistemit të Sigurisë: Duke përkrahur Sigurinë dhe Drejtësinë*, 2007.

Organizata

DCAF – www.dcaf.ch

Vigjilenca ndërkombëtare – www.international-alert.org

UNIFEM Portal për femrat, Paqen dhe sigurinë –

www.womenwarpeace.org

UN-INSTRAW – www.un-instraw.org

WILPF Peacewomen – www.peacewomen.org

Gjinia dhe Vegla SSR

1. Reforma e sektorit të sigurisë dhe gjinia
 2. Reforma e policisë dhe gjinia
 3. Reforma e mbrojtjes dhe gjinia
 4. Reforma e drejtësisë dhe gjinia
 5. Reforma e penalizimit dhe gjinia
 6. Menaxhimi me kufijt dhe gjinia
 7. Mbikqyrja parlamentare e sektorit të sigurisë dhe gjinia
 8. Bërja e politikës së sigurisë kombëtare dhe gjinia
 9. Mbikqyrja e shoqërisë civile e sektorit të sigurisë dhe gjinia
 10. Kompanitë private ushtarake dhe të sigurisë dhe gjinia
 11. SSR vlerësimi, vëzhgimi dhe evaluimi dhe gjinia
 12. Trajnimi gjinor për personelin e sektorit të sigurisë
- Shtojcë për Ligjet dhe instrumentet ndërkombëtare dhe regionale

Çdo njëra nga këto vegla dhe shënime praktike gjithashtu janë në disponim në: www.dcaf.ch, www.un-instraw.org and www.osce.org/ odih.

Ky shënim praktik është pregaditur nga Rahim Kanani i UNINSTRAW, bazuar mbi Veglën 9 e shkruar nga Karen Barnes dhe Peter Albrecht të Vigjilencës Ndërkombëtare.

¹Caparini, Cole dhe Kinzelbach, Mbikqyrja publike e sektorit të sigurisë: Një doracak për CSO për qeverisjen e sigurisë demokratike (Renesans: Bratislava), korrik i ardhshëm 2008.

² Adaptuar nga: OECD DAC. OECD DAC Doracak për reformën e sistemit të sigurisë: Duke përkrahur sigurinë dhe drejtësinë (OECD DAC: Paris), 2007, p. 117.

³ Adaptuar nga: "Kampanja e rripit të bardhë".

http://www.whiteribbon.ca/about_us/

⁴ Cituar nga: Albrecht, P., 'Mbrojtje', Mbikqyrja publike e sektorit të sigurisë: Një doracak për CSO për qeverisjen e sigurisë demokratike, eds. Caparini,

Cole dhe Kinzelbach (Renesans: Bratislava), korriku i ardhshëm 2008.